



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1229/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ardian Bytyqi zyrtar për informim nga radha e APL-së në Lipjan, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mospërputhjes të rezultateve, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Ardian Bytyqi, zyrtar për informim nga Aleanca për Lipjanin (APL).

#### Arsyetim

Me datën 03.12.2013 në ora 15:40, Ardian Bytyqi zyrtar për informim nga radha e APL-së ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se ka pasur mospërputhje të rezultateve për subjektin politik Aleanca për Lipjanin (APL) në raundin e parë për kandidatët për asamble komunale në dëm të APL, ku sipas rezultateve të publikuara të KQZ-së të datës 02.12.2013 lista për asamble të PDK-së ka 8601 vota, ndërsa sipas të dhënave të APL-së ka 8471 vota, thuhet në pretendimet e ankuesit.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të Ardian Bytyqi zyrtar për informim nga radha e APL-së, janë të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindse pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi, për të vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr. 1229/2013 më datën 06.12.2013.



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.